



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; [kqz.sekretariati@kqz-ks.org](mailto:kqz.sekretariati@kqz-ks.org); [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org)

**Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

**Nr. 71**

Datë: 21. 12. 2017, ora: 14:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

---

**RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.70/2017*

2. Shpallja e rezultateve përfundimtare të rivotimit për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunës në Istog;

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- Këshillit për Çështje Ligjore

*-Shqyrtimi dhe Miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal*

4. Të ndryshme;

## **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.70/2017*

**Valdete Daka:** Përshëndetje, mirë se keni ardhur në mbledhjen e 71 të KQZ-së. A ka dikush lidhje diçka me rendin e ditës? Nëse jo, kush është për këtë rend dite?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës. Dhe në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin nr. 70.*

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me pikën e dytë.

## **2. Shpallja e rezultateve përfundimtare të rivotimit për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunës në Istog**

Valdete Daka: I keni të gjithë rezultatet përfundimtare nga QNR-ja. Po ashtu, e kemi edhe konfirmimin nga Gjykata Supreme, se pran kësaj gjykate lidhur me rezultatet. A ka nevojë ti lexoj? Statistikat janë: numri i votuesve të regjistruar 47683. Numri i votuesve të cilët kanë votuar në secilin vendvotim 19869, numri i votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendit 505 pjesëmarrja 42.73%. Numri i pranuar i fletëvotimeve të vlefshme është 20052, numri i fletëvotimeve të pavlefshme është 139 dhe numri i pa fletëvotimeve të zbrazëta 11. Numri i fletëvotimeve të përdorura 20202, numri i fletëvotimeve të pa përdorura 24607 dhe numri i fletëvotimeve të dëmtuara 11. Ndërkaq, kandidati Haki Rugova nga Lidhja Demokratike e Kosovës ka marr gjithsej 10033 vota apo 50.03%. Kurse, kandidati Gani Dreshaj nga Aleanca për Ardhmërin e Kosovës ka 10019 vota apo 49.97%.

I keni edhe votat me kusht, nëse ka nevojë ti lexoj. Këto janë rezultatet përfundimtare. A ka dikush diçka me thënë? Nëse jo. Kush është për shpalljen e rezultateve përfundimtare, për miratimin e këtyre rezultateve? Faleminderit. Kush është kundër?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan shpalljen e rezultateve përfundimtare të rivotimit për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunës në Komunën e Istogut me një votë kundër (Binak Vishaj)*

Nga ky moment, rrjedh afati për ankesa në PZAP, lidhur me rezultatet përfundimtare, dhe afati është 24 orësh.

**Betim Gjoshi:** Kryetare, ka qenë mirë që rezultatet me u publiku në ueb faqen tonë, dhe me na përcjell në imell të dhënat tjera për vendvotime dhe statistikat për secilin vend votim.

## **3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshillit për Çështje Ligjore**

*Shqyrtimi dhe Miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal*

**Sami Hamiti:** Faleminderit kryetare. Në mbledhjen që është mbajtur nga Këshilli, është shqyrtuar dokumentacioni lidhur me kërkesat nga Kuvendet Komunale të Junikut, Lipjanit, Dragashit dhe Gjakovës. Dhe, këshilli konstaton se kërkesat janë të arsyeshme dhe i plotësojnë kushtet ligjore që të bëhen këto zëvendësime....

**Valdete Daka:** Faleminderit, atëherë kush është që në komunën e Junikut, Kreshnik Maloku të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal, në vend të Fatos Shalës, nga subjekti politik PDK...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim*

**Valdete Daka:** Faleminderit. Kush është që Naim Jahiri nga Kuvendi Komunal i Komunës së Lipjanit ta zëvendësojë anëtarin e kuvendit Avni Ollurin nga subjekti LDK...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim*

**Valdete Daka:** Kush është për, po ashtu në Komunën e Lipjanit, Ramadan Tasholli ta zëvendësoj Rasim Hasanin nga subjekti LDK...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim*

**Valdete Daka:** Përsëri nga komuna e Lipjanit: Kush është për që Majlinda Sylejmani, ta zëvendësoj Vlora Limanin nga subjekti politik LDK...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim*

**Valdete Daka:** Kush është për që, po ashtu nga Komuna e Lipjanit, Fehmi Rexhepi ta zëvendësoj Lulzim Qerimin nga subjekti politik PAI...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim*

**Valdete Daka:** Kush është për që në Komunën e Dragashit, Munir Jonuzi ta zëvendësoj Behar Haxhi - Hasanin nga subjekti VAKAT...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim*

**Valdete Daka:** Kush është për që në Komunën e Dragashit, Velid Haxhisin ta zëvendësoj anëtarin Usmend Baxhmi nga subjekti VAKAT...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim*

**Valdete Daka:** Kush është për që në Komunën e Gjakovës, Albina Sadria ta zëvendësoj Saranda Hysenin nga subjekti politik AAK...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim*

**Valdete Daka:** Kush është për që në Komunën e Gjakovës, Miranda Lushaj nga subjekti politik PDK, ta zëvendësoj Adelina Shehu – Kolaj...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim*

**Valdete Daka:** Kush është për që në Komunën e Dragashit, Floren Rufati ta zëvendësoj Selami Sahitin nga subjekti AAK...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për zëvendësim*

#### **4. Të ndryshme**

**Miradie Mavriqi, drejtoresh e ZRPP-së:** Vetëm desha t’ju njoftoj se Auditori i përzgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, i ka përfunduar auditimet e Raporteve Financiare, dhe do t’i publikoj (së bashku me raportin e auditimit të dorëzuar të partive politike). Sot, sapo i ka dorëzuar...

#### **Për KQZ**

**Valdete Daka, kryetare**

-----